

VENDIM
Nr.756, datë 15.9.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.279, DATË 18.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT, PËR
TË CILAT KËRKOHEK VLERËSIMI I DETYRUAR I KONFORMITETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 27 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore” dhe të neneve 5, 6, 7 e 10 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e produkteve të ndërtimit, që i nënshtrohen vlerësimit të detyruar të konformitetit, të miratuar me vendimin nr.279, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STANDARDI QË SHFUQIZOHET	EMËRTIMI I PRODUKTIT	ZËVENDËSOHET NGA STANDARDI	EMËRTIMI I STANDARDIT
S SH EN 413-1:2004	ÇIMENTO PËR MURATURË PJESA 1:SPECIFIKIME	S SH EN 413-1:2006	ÇIMENTO PËR MURATURË PJESA 1: SPECIFIKIME
S SH EN 1916:2002	TUBAT DHE AKSESORËT PREJ BETONI, PREJ BETONI TË ARMUAR DHE PREJ BETONI ME FIBRA ÇELIKU	S SH EN 1916:2008	TUBAT DHE RAKORDERI PREJ BETONI I PAPËRFORCUAR DHE I PËRFORCUAR ME FIBRA ÇELIKU
S SH EN 1917:2002	DHOMA INSPEKTIMI DHE PUSE LIDHJESH PREJ BETONI TË PAARMUAR ME SHUFRA HEKURI DHE TË ARMUARA	S SH EN 1917:2008	PUSETA BETONI DHE DHOMËZA INSPEKTIMI TË PAPËRFORCUARA DHE TË PËRFORCUARA ME FIBRA
S SH EN 12620:2002	MATERIALE INERTE PËR PRODHIMIN E BETONEVE	S SH EN 12620:2008	AGREGATE PËR BETON
S SH EN 13986:2004	PLLAKA ME BAZË DRURI PËR KONSTRUKSIONE KARAKTERISTIKAT, VLERËSIMI I KONFORMITETIT DHE MARKIMI	S SH EN 13986:2005	PANELE ME BAZË DRURI PËR PËRDORIM NË NDËRTIM KARAKTERISTIKAT, VLERËSIMI I KONFORMITETIT DHE MARKIMI
S SH EN 13242:2002	AGREGATE PËR MATERIALE LIDHËSE HIDRAULIKE DHE JOLIDHËSE, PËR PËRDORIM NË INDUSTRIË CIVILE DHE NDËRTIMIN E RRUGËVE	S SH EN 13242:2007	AGREGATE PËR MATERIALE HIDRAULIKISHT LIDHËSE DHE JOLIDHËSE, PËR PËRDORIM NË INXHINIERINË CIVILE DHE NDËRTIMIN E RRUGËVE
S SH EN 14411:2003	PLLAKA QERAMIKE PËRKUFIZIME, KLASIFIKIME/KARAKTERISTIKA DHE MARKIMI	S SH EN 14411:2006	PLLAKA QERAMIKE PËRKUFIZIME, KLASIFIKIME/KARAKTERISTIKA DHE MARKIMI